



Implemented by  
**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



## FTESË PËR PJESËMARRJE 3 DITË NË FRUIT LOGISTICA BERLIN 2023

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, GIZ dhe Risi Albania në cilësinë e bashkëorganizatorit, ju ftojnë të bëheni pjesë e panairit "**Fruit Logistica**" në datat 8 – 9 – 10 Shkurt 2023.

**Fruit Logistica** është panairi më i madh tregtar në botë për biznesin ndërkombëtar të frutave dhe perimeve të freskëta, që mbulon çdo sektor të biznesit të produkteve të freskëta dhe siguron një tablo të plotë të inovacioneve, produkteve dhe shërbimeve më të fundit në çdo hallkë në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit. Ofron mundësi të shkëlqyera të rrjetëzimit dhe kontaktit për vendimmarrësit kryesorë në çdo sektor të industrisë përmes shkëmbimit të informacioneve, krijimin e kontakteve dhe kontratave të bashkëpunimit.

3.500 ekspozues dhe 85.000 vizitorë tregtarë marrin pjesë në **Fruit Logistica** çdo vit për të promovuar potencialin e tyre të plotë të biznesit brenda tregtisë ndërkombëtare të produkteve të freskëta dhe për të shkruar historinë e tyre të suksesit!

Panairi do të zhvillohet në Berlin - Gjermani, dhe grupet e synuara janë sipërmarrjet që operojnë në sektorin e fruta – perimeve, pikat e grumbullimit, përpunues dhe agropërpunues.

Ftojmë të gjitha kompanitë e sipërpërmendura që kanë çertifikim GlobalG.A.P si dhe mundësi dhe sasi eksportuese të marrin pjesë duke na dërguar me email një prezantim të kompanisë, çertifikimin GlobalG.A.P si dhe mundësinë eksportuese.

Pjesëmarrja juaj në këtë Panair mbështetet nga Ministria e Bujqësisë, GIZ dhe Risi Albania.

*Për të siguruar pjesëmarrjen, konfirmoni brenda datës **25 Janar 2023** në [info@bujqesia.gov.al](mailto:info@bujqesia.gov.al)*

*Në vijim, do t'ju informojmë mbi detaje të mëtejshme rreth pjesëmarrjes suaj në këtë aktivitet.*